



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë, 03/11/2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 02/11/2020 të parashtruar nga *Operatori ekonomik N.T. "Biti com"* Podujevë lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Furnizimi dhe mbjellja e drunjeve dekorativ në qytet dhe fshatra me nr te prokurimit 613-20-5899-121** nxjerr këtë ;

VENDIM

Aprovohet pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim, e parashtruar nga *Operatori ekonomik N.T. "Biti com"* Podujevë pjesëmarrës në tenderin me titull: **Furnizimi dhe mbjellja e drunjeve dekorativ në qytet dhe fshatra me nr te prokurimit 613-20-5899-121**

Anulohe Vendimi i AK për dhënien e kontratës të publikuar me datë: 27/10/2020 dhe kthehet lënda në Rivlersim;

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori ekonomik N.T. "Biti com" Podujevë pjesëmarrës në tenderin me titull: **Furnizimi dhe mbjellja e drunjeve dekorativ në qytet dhe fshatra me nr te prokurimit 613-20-5899-121**, me datë 02/11/2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e lartpërmendur. Autoriteti Kontraktues, me datë 03/11/2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Tenderi i operatorit të rekomanduar për kontratë është vlerësuar me kujdes dhe gjatë vlerësimit AK ka zbatuar me përpikëri dispozitat nga LPP dhe rregullat e nxjerra nga KRPP përveç që gjatë dorëzimit të


Vërtetimit të ATK- ë nga operatori i rekomanduar për kontratë i cili ka sjellë vërtetimin i cili nuk i plotëson kushtet e tenderit pasi që është Vërtetim për aplikim për vizë e jo për aplikim për tender . Sa i për ketë listës së kontratave Autoriteti kontraktues duhet të kërkojë sqarim sa i përket datës së fillimit dhe përfundimit të kontratave të paraqitura sepse operatori i rekomanduar për kontratë ka sjellë referencat dhe listën për kontratat e nënshkruara por kjo listë nuk është e plotë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

Adem Duriqi



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit